



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03.10.2017
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-2821/17
PËR/ZA/TO:	z. Dejan Krstic, Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Trepça – Ndërmarrje nën Administrim të AKP-së
CC:	
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, <i>Shqip</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Prokurimi i Makinerive të Ngarkimit dhe Transportit "

I nderuar z. Krstic,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Prokurimi i Makinerive të Ngarkimit dhe Transportit ", me numër të prokurimi: 12054-17-3992-111, me nr. të brendshëm: T04/2017, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " *Prokurimi i Makinerive të Ngarkimit dhe Transportit* ", me numër të prokurimi: 12054-17-3992-111, me nr. të brendshëm: T04/2017, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), me datë 27.09.2017, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-2821/17*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull " Prokurimi i Makinerive të Ngarkimit dhe Transportit ", me numër të prokurimi: 12054-17-3992-111, me nr. të brendshëm: T04/2017, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Trepça – Ndërmarrje nën Administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar Njoftimin për kontratë, Dosjen e Tenderit dhe pjesën e Specifikimeve teknike, ku tek pjesa e kriterëve për dhënie të kontratës, Agjencia ka vërejtur se Autoriteti Kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**, ndërsa si nën kriterë i ka caktuar : 1. Çmimi të cilit i ka caktuar koeficientin prej 0,60, nën kriteri **2. Afati i fundit i dorëzimit të mekanizimit me koeficient 0,15**, nën kriteri **3.** Karakteristikat funksionale, teknik, dhe të ngjashme me koeficient 0,20 dhe nën kriteri **4.** Shërbimet pas shitjes të cilës i ka caktuar koeficient prej 0,05.

Në lidhje me nën kriterin **2** ku është caktuar **Afati i fundit i dorëzimit të mekanizimit me koeficient 0,15**, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nuk është në pajtim me Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik. Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve për dhënie të kontratës, sipas Legjislacionit në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kriterë për dhënien e Kontratës, andaj konsiderojmë se ky kriter i vendosur nuk është kriter i matshëm dhe do duhej të caktohej si kriter minimal për kualifikim.

Autoriteti Kontraktues duhet të këtë kujdes që në rast se përcaktohet për këtë kriter për dhënie të kontratës të caktoj nën kriterë të qarta, precize dhe të cilat janë kriterë të matshme.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **52** Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin **28** të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të mos i përsërisë praktikën e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !